



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023  
ME ZGJEDHJE – SESIONI I  
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: GJEOGRAFI

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	C	B	C	A	A	B	A	B	A
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja e saktë	C	B	A	B	D	B	D	C	D	B

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21 2 pikë

Model përgjigjeje

- Paralelet shërbejnë për të përcaktuar gjerësinë gjeografike, ndërsa meridianët gjatësinë gjeografiko.
- Përmasat e paraleleve ndryshojnë, duke u zvogëluar nga ekuatori në drejtim të poleve, ndërsa meridianët janë të gjithë të barabartë.
- Paralelet tregojnë drejtimin perëndim-lindje ndërsa meridianët veri-jug.
- Etj.

2 pikë Nëse jep dy ndryshime midis paraleleve dhe meridianëve.

1 pikë Nëse jep një ndryshim midis paraleleve dhe meridianëve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 22

Model përgjigjeje

a) 1 pikë

Puhia detare OSE Briza detare

1 pikë Nëse emërton erën e treguar në figurë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

b) 1 pikë

Shkaku kryesor i formimit të saj është ndryshimi i temperaturës dhe i trysnisë atmosferike midis detit dhe tokës.

1 pikë Nëse tregon shkakun e formimit të erës

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

Sepse uji i detit gjatë ditës është më i ftohtë se toka, kështu që trysnia mbi det është më e madhe sesa mbi tokë dhe era fryn në drejtimin nga deti drejt tokës.

**OSE**

Trysnia mbi det, ditën është më e lartë sesa mbi tokë.

**1 pikë**

Nëse tregon pse drejtimi i erës është nga deti drejt tokës

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 23

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Në gjerësitë gjeografike tropikale:

**1 pikë**

Nëse përcakton saktë gjerësinë gjeografike

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

- Temperaturat e larta.
- Thatësira e ajrit.
- Avullimi i madh.
- Mungesa e reshjeve.
- Etj.

**1 pikë**

Nëse jep një nga arsyet.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

### Pyetja 24

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Kufijtë divergjentë

**OSE**

Kufijtë ndërtues

**1 pikë**

Nëse emëron saktë kufijtë e pllakave tektonike.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) **1 pikë**

- formohet një e çarë e quajtur rift.
- formohen kreshtat mesoqeanike.
- zgjerohet fundi i oqeanit.
- Etj.

**1 pikë**

Nëse përcakton se çfarë ndodh kur pllakat tektonike largohen nga njëra-tjetra

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

### Pyetja 25

**Model përgjigjeje**

a) **1 pikë**

Shpërndarjen e tërmeteve

**OSE**

Shpërndarjen e vullkaneve

**1 pikë**

Nëse përcakton saktë dukurinë gjeografike.

**0 pikë**

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

Zona përreth Paqësorit ku ndodhin 80% e të gjithë tërmeteve në botë.

**OSE**

Unaza e Zjarrtë e Paqësorit ku ndodhen 80% e vullkaneve.

**1 pikë** Nëse identifikon zonën ku dukuria është më e përhapur.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 26 2 pikë****Model përgjigjeje**

- Singapori
- Malajzia
- Indonezia
- Etj

**2 pikë** Nëse rendit dy nga shtetet.

**1 pikë** Nëse rendit një nga shtetet.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

**Pyetja 27 3 pikë****Model përgjigjeje**

- *Pozita gjeografike:* Evropa Perëndimore ka dalje të gjerë në Oqeanin Atlantik dhe detet e tij duke mundësuar lidhjen me rajonet fqinje e më gjerë
- Etj.
- *Relievi:* Relievi i rajonit është i larmishëm, ku ndërthuren malet me moshë të vjetër me zona të ulta fushore.
- Etj.
- *Rrjeti lumor:* Relievi lumor është mjaft i dendur dhe në pjesën më të madhe lumenjtë janë të lundrueshëm **OSE** Lumenjtë e shumtë mundësojnë një rrjet të dendur të rrugëve të brendshme ujore
- Etj.

**3 pikë** Nëse identifikon tri tiparet dalluese të rajonit të Evropës Perëndimore

**2 pikë** Nëse identifikon dy nga tiparet dalluese të rajonit të Evropës Perëndimore

**1 pikë** Nëse identifikon një nga tiparet dalluese të Evropës Perëndimore

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 28****Model përgjigjeje**a) **1 pikë**

Niveli i lindjeve OSE Niveli i vdekjeve OSE Emigracioni

**1 pikë** Nëse rendit një nga faktorët;

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

Rritja e popullsisë është e shpejtë.

**1 pikë** Nëse paraqet saktë rritjen e popullsisë mbështetur në formën e piramidës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

- Niveli i lindjeve është i lartë (baza e piramidës është e gjerë.

- Moshja e tretë e popullsisë paraqitet në numër më të vogël.

- Mbizotëron grupmosha nën moshën e punës (0-14 vjeç).

- Etj

**1 pikë** Nëse jep një argument që mbështet përgjigjen e dhënë

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 29**            **3 pikë****Model përgjigjeje**

- *Sektori i parë e ekonomisë*: ekonomia bujqësore, pylltaria, peshkimi etj.
- *Sektori i dytë i ekonomisë*: industria, energjitika, ndërtimtaria etj.
- *Sektori i tretë i ekonomisë*: shërbimet, tregtia, transporti, turizmi, artizanati etj.

- 3 pikë**            Nëse përcakton aktivitetet për tri sektorët e ekonomisë.  
**2 pikë**            Nëse përcakton aktivitetet për dy nga sektorët e ekonomisë.  
**1 pikë**            Nëse përcakton aktivitetin për një nga sektorët e ekonomisë.  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 30**            **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ultësira e Evropës Lindore **OSE** Fusha Ruse.
- Obi **OSE** Jenisej **OSE** Lena etj.
- Klima me karakter kontinental.

- 3 pikë**            Nëse përcakton saktë tri veçoritë.  
**2 pikë**            Nëse përcakton saktë dy nga veçoritë.  
**1 pikë**            Nëse përcakton saktë një nga veçoritë.  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
- 

**Pyetja 31**a)                    **1 pikë**

Lumi Rio Grande.

- 1 pikë**            Nëse emërton kufirin natyror.  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) Huron **OSE** Erie **OSE** Ontario **OSE** i Sipërm **OSE** Miçigan.

- 1 pikë**            Nëse emërton një nga pesë Liqenet e Mëdha.  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

c) Gadishulli i Labradorit.

- 1 pikë**            Nëse emërton saktë gadishullin.  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
- 

**Pyetja 32**            **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndalimi i lëvizjes së lirë të njerëzve deri në vitin 1990.
- Kushtet e vështira të jetesës në zona malore.
- Mungesa e infrastrukturës rrugore, shëndetësore, arsimore etj.
- Niveli i lartë i papunësisë për shkak të mbylljes së aktiviteteve ekonomike industriale.
- Etj.

- 3 pikë**            Nëse rendit tri nga faktorët  
**2 pikë**            Nëse rendit dy nga faktorët  
**1 pikë**            Nëse rendit një nga faktorët  
**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
-

**Pyetja 33****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Përbëhet nga shkëmbinj magmatikë.
- Gjendet minerali i bakrit.
- Dimri i ftohtë dhe vera e freskët.
- Malet kryesore janë Bjeshkët e Tërbunit dhe Kushnenit, Krabi, Maja e Malit, Munella etj.
- Ndër gropat përmendim ato të Iballës dhe Pukës.
- Luginat kryesore lumore ajo e Fanit të Madh dhe të Vogël.
- Kurrizet malore kanë shpërndarje rrezore.
- Etj.

**3 pikë** Nëse jep tri nga karakteristikat.**2 pikë** Nëse jep dy nga karakteristikat.**1 pikë** Nëse jep një nga karakteristikat.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 34****3 pikë****Model përgjigjeje**

Bregdeti i Adriatikut	Bregdeti i Jonit
Bregdet i tipit të ulët ranor.	Bregdet i tipit të lartë shkëmbor.
Bregdet i tipit të grumbullimit.	Bregdet i tipit gërryes, (abraziv).
Formohen plazhet ranore, deltat, lagunat e kënetat	Formohen brigjet e thepisura, plazhet kryesisht zallore dhe falezat
Etj.	Etj.

**3 pikë** Nëse shkruan tri ndryshime mes tipeve të bregdeteve.**2 pikë** Nëse shkruan dy nga ndryshimet mes tipeve të bregdeteve.**1 pikë** Nëse shkruan një nga ndryshimet mes tipeve të bregdeteve.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 35****Model përgjigjeje**a) **1 pikë**

Drejtimi rrezor.

**1 pikë** Nëse përcakton saktë drejtimin e relievit.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.b) **1 pikë**

- Mbizotërimit të shkëmbinjve të fortë, si gëlqerorët.
- Shkëputjeve tektonike.
- Lëvizjeve të fuqishme diferencuese.
- Veprimtarisë së faktorëve të jashtëm si karsti, bora, akulli.
- Etj.

**1 pikë** Nëse përcakton arsyen se pse relievi është i ashpër e i copëtuar**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

c)

Lugina e Shalës **1 pikë****1 pikë** Nëse gjen kufirin natyror.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.